

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU / MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj.32186/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINE, me Gjyqtarë *Murat Paçaradën* dhe sekretarin juridik Naim Thaqi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Ejup Muharrem Qerimit, me vendbanim në Fushë Kosovë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 16 paragrafi 1.i sanksionuar me nenin 20 paragrafi 1.1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Intresit në Ushtrimin e Funksonit Publike ,me nr.04/L-051,e në bazë të nenit, 73,74, 195,199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën **15.10.2012** merr këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri **Ejup Muharrem Qerimi** e lindur me 27.01.1961 në fshatin "Zhegër", Komuna e Gjilanit, tani jeton në Fushë Kosovë, Rr "Molla e Kuqe" nr.3/6, Fakultetin e Elektros të kryer, kryen punët dhe detyrat e punës së Kryeshef Ekzekutiv të PTK-së, si dhe është Antar i Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, i martuar, babë i 2 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E

Sepse, nga data 24.02.2012, kur është zgjedhur në funksionin e Kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së, është gjendur në pozitën e konfliktit të intresit, nga se i njejti ishte duke e ushtruar funksionin e Antarit të Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe ate nga data 16.06.2011.

Ushtrimi i këtyre dy funksioneve publike, në Organizatat fitimprurëse siq është PTK-ja dhe Organizata jofitimprurëse siq është Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës si Menaxhues apo anëtar i Organit Menaxhues e kanë vu të pandehurin në situatë të konfliktit të interesit

Me veprim të këtill i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1 ,i sanksionuar me nenin 20. Pargrafi 1.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Intresit në Ushtrimin e Funksonit Publik me nr.04/L-051, andaj për këtë :

D E N O H E T

I pandehuri **Ejup Qerimi** me gjobë në të holla në shumë prej **2000 (dymij) euro** të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merrë formën e prerë, në dobi të të hyrave Gjyqësore të Kosovës, në xhirollogarinë rrjedhëse 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar i pandehuri nuk e paguan në afatin e dhënë e njejta do ti zëvendsohet me dënim burgimi në kohëzgjatje 30 ditësh.

Shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor caktohen konform nenit 109.6 të LMK-së në shumën prej **15 (pesëmbdhjetë) Euro**, të cilat i pandehuri është i obliguar që ti paguaj në arkën e gjykatës.

Pagimi i gjobës bëhet në të gjitha bankat e qytetit.



03-3709/12/02
fmg

2.

-Konform nenit 20.2 të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik të pandehurit i shqiptohet:

Masa mbrojtëse: Ndalim i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 3(tre) muajsh, nga dita kur ky aktvendim të bëhet i plotëfuqishëm.

Ekzekutimin e kësaj mase do ta bëjnë Organet të cilat e kanë zgjedhur të pandehurin në pozitën e lartëcekura, gjegjësisht Bordi Udhëheqës i PTK-së, dhe Kuvendi i Kosovës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi tu dorëzohet: të pandehurit, ushtruesit të kërkesës, Bordit udhëheqës të PTK-së, Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe Sekretarit të Kuvendit të Kosovës.

A R S Y E T I M

Agjencioni Kundër Korrupsionit, me kërkesën ZD/DPK/ me nr.01-2626/12 të parashtruar gjykatës me datën 07.08.2012, ka propozuar që kundër të pandehurit, të zhvillohet procedura kundërvajtëse, të shpallët përgjegjëse dhe të denohet në bazë të Ligjit me nr.04/L-051, për shkak të kundërvajtjes së përshkruar si në dispozitiv.


Sipas kërkesës së parashtruar gjyqtari e zhvilloj procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Ejup Qerimi, i cili në seancën e mbajtur me datën 08.10.2012, mbrojtjen për këtë çështje e paraqiti vet, dhe nëpërmes avokatit Elmi Qerimi sipas autorizimit të datës 08.10.2012.

Në mbrojtjen e vet të dhënë para kësaj Gjykate, i pandehuri deklaroi: Nuk është e vërtetë se unë jam gjendur në pozitën e konfliktit të interesit lidhur me pozitën që mbajë, si anëtar i Bordit të Drejtorëve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe si Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së. Agjencioni kundër Korrupsionit e ka keqinterpretuar Ligjin mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nga se nenin 1 i këtij ligji thotë: Qellimi i këtij ligji është Parandalimi i Konfliktit të Interesit ndërmjet interesit publik dhe atijë privat të zyrtarëve të lartë, kështu që në rastin tim nuk ka interes privat në ushtrimin e këtyre dy funksioneve, sepse të dy këto funksionet janë publike, ashtu që unë nuk kam asnjë interes privat timin. Si Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Trustit Pensional të Kursimeve të Kosovës jam zgjedhur me konkurs publik, dhe jam nominuar nga Aleanca Kosovare e Biznesit, nga Shoqata për Teknologji Informativë dhe Komunikacion si dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Në këtë funksion jam zgjedhur si Përfaqësues Profesional i Punëdhënësve të Kosovës në bazë të funksionit që kam pasur në organizatat e lartëcekura.

Më pastaj i pandehuri deklaroi se edhe sipas nenit 16 të Ligjit me nr.04/051, nuk jam gjendur në pozitën e konfliktit të interesit sepse i përfaqësoj punëdhënësit e Kosovës.

Avokati i të pandehurit Elmi Qerim thotë se e mbështes në tërësi deklaratën e të pandehurit, më pastaj shton se konflikti i interesit si në sektorin publik po ashtu edhe atij privat është bërë një qeshtje madhore e shqetësimi i publikut në vende të ndryshme, e po ashtu edhe në vendin tonë. Më pastaj avokati i të pandehurit foli rreth historikut të konfliktit të interesit, përkufizimin dhe definicionin e konfliktit të interesit duke theksuar se “konflikti i interesit përfshin konfliktin midis detyrës publike dhe interesave private, të një zyrtari publik që mund të ndikojnë në mënyrë të gabuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të tij zyrtare”

Duke vazhduar mbrojtjen avokati i të pandehurit thekson se nuk është vetëm Agjencioni Kundër Korrupsionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, por ka edhe nivele tjera dhe struktura tjera përgjegjëse për zbatimin e ligjit që kanë të bëjnë me Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Tek Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, është Banka Qëndrore e Kosovës, si autoritet, që kujdeset për efektet të padëshiruara si dhe paraqitjen e parregullsisë që mund të rezultojnë në çfarëdo konflikti të interesit në mes të përgjegjësit, tani të pandehurit si Anëtar i Bordit Udhëheqës në Trustin Pensional të Kursimeve të Kosovës, dhe interesit të tij personal. Ndërsa sa i përket postit të dytë, Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së, mbikqyrjen e zbatimit të ligjit e bënë Bordi i Drejtorëve të PTK-së, i cili kujdeset për çfarëdo konflikti të interesit në mes përgjegjësisë së të pandehurit si Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së dhe interesit personal. Kjo gjë shihet edhe në opinionet legale të marrura nga ky Bord me datën 30.08.2012, e të plotësuar me datën 17.09.2012, ku është konstatuar se i pandehuri si Kryeshef



03-3709/12/03
sluz

3.

Ekzekutiv i PTK-së nuk gjendet në pozitë të konflikt të interesi në asnjë shtate, dhe se Agjencioni Kundër Korrupsionit nuk ka prezentuar kurrfar fakti me të cilin dëshmohe se i pandehuri është në konflikt interesi. Në vazhdim të mbrojtjes avokati i të pandehurit ka vërejtje edhe në punën e Agjencionit Kundër Korrupsionit sepse e njehta siq thotë avokati i të pandehurit po përdor standarde të dyfishta rreth trajtimit të konfliktit të interesit.

Për sqarimin edhe më mirë të kësaj qështje gjyqtari thirri në cilësin e dëshmitarit ushtruesin e kërkesës për hapjen e procedurës kundërvajtëse Frashër Murtezaj, zyrtar i lartë në Agjencionin Kundër Korrupsionit i cili në seancen e datës 09.10.2012 deklaroi: Ne si Agjencion mbesim pranë kërkesës për hapjen e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit Ejup Qerimi, nga se i njehti është gjendur në pozitën e konfliktit të interesit të paraparë me nenin 16 të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, sepse i njehti i ushtron dy funksione publike: Antari i Bordit të Drejtorëve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës në Prishtinë, dhe Kryeshefi Ekzekutiv në PTK-në e Kosovës

Pas shtjellimit të provave gjatë procedurës, shiqimit të të dhënave në kërkesë, provave të parshtruara nga i pandehuri, provave të parshtruara nga parashtruesi i kërkesës, deklaratën e të pandehurit, deklaratën e ushtruesit të kërkesës në cilësinë e dëshmitarit, gjyqtari ka fituar bindjen se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen me të cilën ngarkohet dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv.

Me rastin e marrjes së vendimit gjyqtari gjeti se i pandehuri nga data 16.06.2011 në bazë të konkursit publik është zgjedh antar i Bordit të Drejtorëve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Nga data 24.02.2012 prap në bazë të konkursit publik i pandehuri zgjedhet në postin e Kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së, fakte të cilat i pohon edhe vet i pandehuri.

Këto dy organizata ku i pandehuri ushtron detyra menaxheriale e kanë subjektivitetin e plotë aktiv dhe pasiv në qarkullimin juridik.

Të dyja këto pozita janë të karakterit Menaxherial, ku urdhërat dhe vendimet e tyre janë të karakterit obligativ për punëmarrësit, dhe asetet e tyre. Kjo punë pra nuk është punë honorari apo punë e kohëpaskohëshme, sepse edhe shpërblimi për kryerjen e këtyre punëve bëhet çdo muaj, i cili shpërblim (pagë) e tejkalon disa herë pagën mujore të të punësuarve në vend, në të dyja këto subjekte ku i pandehuri kryen këto funksione menaxheriale.

I pandehuri e konteston se ka ardh në situatë të konfliktit të interes nga se është i deleguar nga punëdhënësit dhe se i përfaqëson interesat e tyre në Trustin Pensional të Kursimeve të Kosovës.

Gjyqtari gjeti se vertët i pandehuri kur është zgjedhur si antar i Bordit të Drejtorëve në Trustin Pensional të Kursimeve të Kosovës, post me fuqi menaxhuese, në cilësinë e përfaqësuesit të punëdhënësve privat me datën 16.06.2011, nuk ka pasur kurrfar konflikti të interes nga se i njehti ka ardhur në këtë post me konkurs, si përfaqësues i punëdhënësve privat, që i ka përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e atyre që e kanë nominuar.

Kjo gjendje ka zgjat deri më 24.02.2012 kur i pandehuri nëpërmes konkursit publik zgjedhet Kryeshefi Ekzekutiv i PTK-së, prap post me fuqi menaxhuese dhe vendimarrëse për punëmarrësit, dhe asetet e kësaj kompanie publike.

Pra, nga data 24.02.2012, i pandehuri gjendet në dy pozita menaxheriale, atë të anëtarit të Bordit të

Drejtorëve të Trustit Pensional të Kursimeve të Kosovës, dhe atë të Kryeshefit ekzekutiv të PTK-së.

Nga data 24.02.2012 krijohet një situatë dhe gjendje tjetër, nga se i pandehuri tash bie ndesh me nenin 16.1 të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në të cilin thuhet "Zyrtari i Lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike, si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit"

Bazur në dispozitat e këtij neni të cituar më lartë del se i pandehuri është Menxhues i Organizatës fitimprurëse siq është PTK-ja dhe Organizatës jofitimprurëse siq është Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Pra, sipas nenit 16.1 i pandehuri nuk është përfaqësues apo i deleguar nga ndonjë subjekt politik, në këto dy organizata në të cilat tash i pandehuri e ka postin e Menaxherit, si Kryeshefi Ekzekutiv i PTK-së, dhe anëtar i Bordit Menaxhues në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

4.

Gjithashtu i pandehuri nuk zgjedhet në këto dy funksione për shkak të pozitës që ka pasur në ndonjë subjekt tjetër, e po të ishte kështu ai do të shkonte në menyre automatike në këto funksione, apo nga ndonjë e drejtë që del nga ndonjë funksion i mëparshëm, por i pandehuri nominohet që të hyj në këtë garë për pozitën e anëtarit të Bordit të Drejtorëve në Trustin Pensional të Kursimeve të Kosovës në bazë të konkursit, nga asociacioni i punëdhënësve privat, për ti prezentuar dhe mbrojtur interesat e tyre. Nuk është kontestuese që punëdhënësit privat ta kenë përfaqësuesin e tyre në Bordin e Drejtorëve në Fondit Pensional të Kosovës, si pozitë manaxhuese, vendimarrëse, ku ruhen, deponohen, këto kursime me qëllim që nëpërmes kamatave të shtohet vlera e tyre, sepse këtë ja u garanton Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës me nr.04/L-101, mirpo është në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me nr.04/L-051, kur në të të njëjtën kohë përfaqësuesi i këtyre punëdhënësve, tash i pandehuri, ta ushtron edhe ndonjë funksion Menaxhues në ndonjë Organizat publike fitimprurëse, siq është PTK-ja.

Avokati i të pandehurit edhe pse e pranon se Autoriteti Qendror për zbatimin e Ligjit për Parandalim e Konfliktit të Interesit është Agjencioni Kundër Korrupsioni, thekson se ka edhe nivele tjera që kujdesen për zbatimin e këtij ligji, siq është Banka Qendrore e Kosovës e cila kujdeset për zbatimin e Ligji mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, posaqërisht kur është fiala për anëtarët e Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale.

Sa i përket detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së të cilën e ushtron tash i pandehuri, për shmangien dhe shkeljen e Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kujdeset Bordi Udhëheqës i PTK-së.

Bordit i Drejtorëve të PTK-së kanë dhënë opinionin e tyre të cilët mendojnë se Kryeshefi Ekzekutiv i këtij subjekti nuk ka ardh ndesh me ligjin për konfliktin e interesit, me të cilin është njoftuar Agjencioni Kunder Korrupsionit.

Gjyqtari gjeti se nuk është kontestuese se kur vërehen shkeljet e Ligjit mbi konfliktit të intresit, lajmërimi apo reagim ndaj kësaj dukurie është detyrë e organeve ku paraqiten këto dukuri, por është edhe detyrë e qdo qytetari të vendit.

Mirpo është e pakontestueshme se Agjencioni Kundër Korrupsionit është autoriteti qëndror kryesorë që jo vetem të kujdeset, por e ka edhe obligim ligjor që sipas detyrës zyrtare të reagoj në momentin kur dyshohet se shkelen dispozitat e Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të cilat kompetenca i janë dhënë sipas ligjit në fjalë.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, dhe pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veq e veq, dhe të gjitha provave së bashku, gjyqtari fitoj bindjen e lirë se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen me të cilën ngarkohet.

Andaj të pandehurin e dënoj me këtë lloj dënimi dhe ja shqiptoj masen mbrojtëse duke llogaritur se do të ndikojn pozitivisht, që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tilla apo të ngajshme.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit gjyqtari vlerësoj të gjitha rethanat nga neni 7 i LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja.

Konform nenit 109.6 të LMK-së caktohen shpenzimet e procedurës kundërvajtëse.

Me sa u cek ma lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. regj:32186/12, datë 15.10.2012

GJYKATËSI

Murat Paçarada

UDHËZIME MBI NJETIN JURIDIK Kundër këtij aktvendimi të drejtë ankese kanë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës, Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate, dhe pa taksa gjyqsore.